



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KËLCYRË

Nr. 1099 Prot.

Këlcyrë, më 30/04/2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR KËSHILLIN VENDOR TË RINISË  
KËLCYRË**

Bashkia Këlcyrë shpall thirrjen publike për Këshillin Vendor të Rinisë. Thirrja është e hapur për të gjithë të interesuarit që plotësojnë kriteret, nga të cilët 4 prej tyre do të bëhen pjesë e Këshillit Vendor të Rinisë.

**Kriteret dhe përbërja e Këshillit:**

- Këshilli përbëhet nga Kryetari i Bashkisë, përfaqësuesi i rinisë në Bashki dhe 4 të rinj, të përzgjedhur sipas kriterëve ligjorë;
- Kandidatët duhet të jenë banorë të Bashkisë Këlcyrë dhe të moshës 15-29 vjeç;
- Për përfaqësuesit e organizatave rinore kërkohet:
  - Të jenë përfaqësues të një organizate rinore ose për të rinjtë;
  - Të mos kenë dënime penale;
  - Të mos kenë konflikt interesi në lidhje me angazhimin në KVR.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Kërkesë me shkrim ku shprehet interesi dhe motivimi për aplikim;
- Jetëshkrim (CV);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Vetëdeklarim për shmangien e konfliktit të interesit;
- Referenca nga të paktën 2 bashkëpunëtorë të mëparshëm;

**Dorëzimi i aplikimit bëhet në Zyrën e Protokollit të Bashkisë Këlcyrë.**

**Afati i fundit: 15.05.2026**

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e tyre bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e mbylljes së aplikimeve. Njoftimi i fituesve do të publikohet në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

**KRYETARI I BASHKISË  
Klement Ndoni**

